

RAPORTI PER FUNDIMTAR I
GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
PËR PROGRAMIN E STUDIMIT

BACHELOR në Psikologji Këshillimi dhe
Pedagogji

TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “HËNA E
PLOTË” (BEDËR)

Ekspert: **1. Prof. Dr. Milika Dhamo**
 2. Prof. Dr. Tatjana Cadri

Prill 2013

Parathënie për Procesin e Vlerësimit të Jashtëm

I. PARIMET E PUNËS SË GVJ

- Besimi
- Vlerësimi i mbështetur në dokumente të paraqitura nga GVJ, Institucioni etj.
- Profesionalizmi, vërtetësia,
- Objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe
- Përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.

Objektivat kryesore të procesit të vlerësimit janë:

- Të zbulojë fakte që bëjnë sa më të qartë gjendjen e një institucioni, apo programi studimi në Arsimin e Lartë, në kohë reale dhe në kontekstin kombëtar e ndërkombëtar
- Të bëjë publik informacionin, me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për cilësinë e IAL, programeve të studimit, diplomave e shërbimeve që ato ofrojnë
- Të japë një bazë të mjaftueshme të dhënash, rekomandimesh e konsideratash profesionale, që do të shërbejnë si pikënisje për procesin e mëtejshëm të akreditimit.
- Të shërbejë për kultivimin e kulturës së cilësisë në IAL e cila shihet në ndërtimin e strukturave, praktikave dhe procedurave të brendshme të vlerësimit të cilësisë, struktura të cilat kombinojnë eksperiencën e fituar gjatë vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.

II. ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË JASHTËM

- Miratimi i kërkesës së IAL dhe përcaktimi i afateve kohore të Vlerësimit të Jashtëm
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) nga APAAL dhe miratimi i përbërjes së tij në KA. APAAL mori pjesë me anëtarë, sipas madhësisë së grupit.
- Njoftimi i IAL për përbërjen e GVJ dhe afatet kohore të Vlerësimit të Jashtëm
- Kontraktimi i anëtarëve të GVJ
- Trinimi i GVJ nga stafi i APAAL dhe njohja me Dosjen e Vetëvlerësimit
- Hartimi nga APAAL i programit të vizitës/ave në vend (agenda) nga GVJ.
- Njoftimi i titullarit të IAL për programin që do të ndjekë GVJ gjatë vizitave në këtë institucion
- Kryerja e procesit të vlerësimit të jashtëm (shih më poshtë).
- Dorëzimi i Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm nga GVJ.
- Dërgimi i Draft-Raportit të GVJ në IAL
- Ardhja e vërejtjeve/Miratimit të IAL për draft RVJ
- Dorëzimi i Raportit përfundimtar të Vlerësimit të Jashtëm

III. PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

RVJ mund të përbëhet nga *12 Rubrika kryesore*. Çdo rubrikë që kërkohet të analizohet mund të përbëhet nga tre pjesë:

- ❖ Pjesa përshkimore
- ❖ Tregues të matshëm (Të dhëna, shoqëruar me Anekset).
- ❖ Vlerësimi sipas Standardeve

Në pjesën përshkrimore, GVJ sipas termave të referencës përshkruan aspektin përkatës të vlerësimit. Në pjesën e treguesve të matshëm GVJ do të japë të dhëna sasiore, tabela etj, të cilat vërtetojnë përfundimet e pjesës përshkrimore. Ndërsa në pjesën e vlerësimit cilësor sipas standardeve, GVJ do të përgjigjet konkretisht për çdo kriter dhe për çdo standard, nëse plotësohet apo jo.

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM **Për Programin e studimit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji**

HYRJE

Programi i studimit në nivel Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është program i miratuar me Urdhë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës më datë Nr.330, datë 07.08.2012.

Shkolla e lartë Hëna e Plotë Bedër (SHLHPB) është licencuar me VKM Nr. 286 datë 6/4/2011.

Programi ka filluar të ofrohet në tetor 2011. Aktualisht, është mbyllur semestri i parë nga 6 semestra që ka programi i studimit. Të dhënat e mëposhtme mbulojnë këtë periudhë të zhvillimit të mësimi dhe aktiviteteve të tjera rrotull tij.

Përgjegjës për zhvillimin e programit është Departamenti i Shkencave të Edukimit në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit të kësaj shkolle të lartë, ku përgjegjës është Dr. Ahmet Encekli dhe koordinatore e programit Ana Uka (Msc), aktualisht studente doktrate. Për vlerësimin e programit u organizuan një sërë takimesh: ai me Rektorin e SHLHPB, takimi me njësinë e vlerësimit të brendshëm, takimi me përgjegjësin e departamentit, takimi me njësinë e sigurimit të cilësisë, takimi me Znj. Ana Uka, takimi me studentët e programit, me punonjëset e bibliotekës, punonjës të zyrës së burimeve njerëzore, me punonjës të sekretarisë mësimore, të zyrës së regjistrimit të studentëve, si dhe me Kancelarin e Shkollës së Lartë Hëna e Plotë Bedër.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Dr. Milika Dhamo
2. Prof. Dr. Tatjana Cadri

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Programi *Bachelor* në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji pranë Shkollës së Lartë Hëna e Plotë, Bedër synon arsimim cilësor të studentëve për të kontribuar në zgjidhjen e çështjeve sociale, arsimore, psikologjike e kulturore në shoqërinë shqiptare, por edhe me gjerë. Ai ka ambicjen ta arrijë këtë synim duke gërshetuar njohuri nga fusha e Psikologjisë dhe Pedagogjisë në shqyrtimin teorik kritik të krijimeve historike, filozofike, sociologjike, pedagogjike dhe praktikës së shërbimit psikologjik nëpër shkolla.

Programi *Bachelor* në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji synon të përgatisë psikologët nëpërmjet një gërshetimi të mirorganizuar të anës teorike me praktikën, në kushte dhe mundësi fizike bashkëkohore.

Objektivat e programit

Programi Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji synon aftësimin e studentëve për të punuar:

- në institucione publike e private si psikolog këshillimi

- në organizata apo shoqata vendase dhe të huaja, të cilat operojnë në fushën e psikologjisë dhe edukimit
- në organet juridike si punonjës i shërbimeve psikologjik
- në cikle të ndryshme të shkollave si psikologë shkollorë
- në qendra rehabilitimi me persona me aftësi të kufizuar
- në qendër të shëndetit publik dhe qendër spitalore si psikologë të këshillimit
- në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë pasi të ketë kryer të paktën ciklin e dytë të studimeve.

Këto synime të programit Bachelor janë më të avancuara së sa vetë brendia e programit (puna në rehabilitim, drejtësi, aftësi e kufizuar, shëndet publik, kërkim shkencor e mësimdhënie). Synimet janë gjithashtu shumë më të larta nga sa njeh tregu (me certifikate Bachelor nuk mund të punësohesh si terapist apo këshillues), pasi studimet Master janë domosdoshmëri sipas Kodit të Psikologut (në proces)..

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi i IAL sipas standardit/ kriterit ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit të Psikologjisë së Këshillimit dhe Pedagogjisë është në përputhje me qëllimet dhe misionin e SHLHPB.</p> <p>Programi i Psikologjisë së Këshillimit dhe Pedagogjisë, niveli Bachelor, ka objektiva përtej asaj që mund të arrihet me pjesët përbërëse të tij. Spektri i punësimit është i gjerë dhe mundësia për të fituar shprehi në to, siç edhe shprehet program nuk mbështetet nga mënyra e ndërtimit të programit. Programi është në përputhje me nevojat e tregut të punës. Programi përshtatet me nivelin ekonomik të vendit.</p> <p>Objektivat e programit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji janë të munguara për pjesën e Pedagogjisë. Përshtatja e profilit të degës me specialistin në treg është e vështirë të bëhet. Emërtimi i degës mbetet i paqartë dhe i pambështetur nga program i studimit. Brendia e kurrikulës nuk reflekton emërtimin e degës.</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi Bachelor Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është në përputhje me strategjinë e SHLHPB.</p> <p>Programi Bachelor Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji synon pajisjen me njohuri, metoda e parime të përgjithshme hyrëse në fushë të psikologjisë, po jo sa duhet në pedagogji.</p> <p>Programi Bachelor Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji synon shprehi në një llojshmëri optimale.</p> <p>Po. Kriteri plotësohet.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi Bachelor Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji synon nevojat e tregut të punës për psikolog dhe specialiste të arsimit.</p> <p>Programi Bachelor Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji ka një përpjekje të dukshme për të rrokur tregun ndërkombëtar të punës. Mësimi kryhet në gjuhën angleze dhe ka student të huaj në masën 50%. SHLHPB ka strategjinë e tij të zhvillimit për këtë program Studimi i tregut është kryer kohë më parë dhe dega është disegnuar mbi të dhënat e tij.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Brendia e këtij programi nuk bien ndesh me interesa kombëtare. Ai është në përputhje me objektivat e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim si dhe me objektivat e disa strategjive sektoriale ku parashikohen shërbime psikologjike për popullata në nevojë.</p> <p>Programi Bachelor për Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji mund të shikojë mundësinë e përfshirjes së vlerave të krijuara tashmë në vend në fushat e psikologjisë dhe të pedagogjisë. Duke qenë së zhvillohet vetëm në gjuhën angleze, me literaturë kryesisht amerikane dhe pjesërisht arabe/turke, nuk u jep studentëve mundësinë të njohin arritjet dhe studimet e zhvilluara e vend. Programi duhet të prezantojë edhe arritjet dhe sfidat e zhvillimit të</p>

Konkluzione të GVJ:

Programi Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji synon kryesisht realizimin e objektivave në fushë të psikologjisë dhe i ka të mangëta synimet në fushën e Pedagogjisë. Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë" Bedër duhet të rishikojë emërtimin e degës: ose të ndryshojë emërtesën duke lënë një program në fushë të psikologjisë, ose ruaje emërtimin e programit, por të pasurojë objektivat dhe kurrikulën duke shtuar pjesën e pedagogjisë.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**Pjesa përshkrimore**

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit pranë Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" Bedër është një nga dy fakultetet e kësaj shkolle. Ai ka tri departamente. Departamenti i Shkencave të Edukimit ofron programin Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji. Organet drejtuese të këtij fakulteti janë Këshilli i Fakultetit, Këshilli i Administrimit të Fakultetit, Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. Sipas ligjit të Arsimit të Lartë, Këshilli i administrimit zgjidhet një për gjithë universitetin dhe nuk atashohet pranë fakultetit. Prania e Këshillit të Administrimit në këtë fakultet është e tepërt. Nga ana tjetër, funksionet e të zgjedhurve në këshillin e administrimit janë në papajtueshmëri me detyra të tjera në Fakultet. Nga këqyrja e listës së anëtarëve të këshillit të administrimit del së individë të caktuar mbajnë poste të papajtueshme si anëtarë të këshillit të administrimit dhe në pozicione të tjera drejtuese në fakultet dhe universitet. Këshilli i lartë i SHLHPB është organ vendimmarrës, por i paekuivalentuar në ligj. Sipas ligjit të AL, organet më të larta vendimmarrëse në universitet janë organet e të zgjedhurve: Senati dhe Këshilli i Administrimit.

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ndan të njëjtën sekretari mësimore dhe zyra administrate si edhe fakulteti tjetër i SHLHPB.

Zyra e pranimit të këtij fakulteti kish një dokumentacion të plotë të studentëve të pranuar për aplikim pranë kësaj shkolle.

Sekretaret mësimore treguan shprehi shumë të mira të menaxhimit të zyrës. Zyra e sekretarisë mësimore ende nuk i kishte pasqyruar në regjistrin themeltar të studenteve studentët e pranuar këtë vit akademik për shkaqë teknike (ende nuk kishin siguruar regjistër pasi MASH kish shtuar elementet e të dhënave që regjistroheshin, e, për pasojë, regjistri aktual i vitit shkollor të mëparshëm nuk mund të përdorej më). Njësia priste regjistrin e printuar nga shtypshkronja. Edhe biblioteka e fakultetit ishte e ndarë me fakultetin tjetër të kësaj njësie. Biblioteka ende nuk kish përfunduar klasifikimin dhe regjistrimin e librave. Fondi i librit për psikologjinë dhe pedagogjinë ishte dukshëm i munguar dhe fondi prezent në bibliotekë ishte i vjetruar. Kancelari tregoi se ish bërë një porosi për një fond të konsiderueshëm librash për fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë. Studentët treguan së shfrytëzonin variante elektronike të librave dhe artikujve që përdornin në lëndë të psikologjisë, po biblioteka nuk dëshmoi abonim në ndonjë biblioteke virtuale. Mbetet që literatura e përdorur të jetë e shkarkueshme pa pagesë nga interneti.

Tregues të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Mënyra e organizimit të fakultetit u prezantua në disa takime me rektorin, përgjegjës të departamentit, profesorë të departamentit, njësinë e vlerësimit të brendshëm dhe njësinë e sigurimit të cilësisë. SHLHPB ka pasqyruar strukturat e veta dhe mjaft të dhëna të tjera për punën dhe organizimin në këtë njësi në faqen e saj të internetit. Faqja zyrtare e fakultetit është e plotë dhe e përditësuar mjaftueshëm.

- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet

Në SHLHPB ekzistojnë strukturat e zgjedhura në të gjitha nivelet. Ato janë struktura multietnike në backgroundin e të zgjedhurve: edhe punonjës me shtetësi turke, edhe punonjës me shtetësi shqiptare. Për t'u parë është përbërja e këshillit të administrimit, anëtarët e të cilit e gëzojnë këtë post në papajtueshmëri me poste të tjera (ai që vendos të jetë i zgjedhur për në këshillin e administrimit nuk duhet të jetë i zgjedhur në poste të tjera drejtuese në shkollën e lartë). Pozicioni i Këshillit të Lartë si organ vendimmarrës komplemento/suprimon Senatin dhe Këshillin e Administrimit. Kjo strukturë është e paparashikuar në ligj. Mund të rishikohet statusi ligjor i tij.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni i ofruar nga personat të cilët u takuan gjatë vlerësimit nga GVJ ishte i mjaftueshëm dhe i ofruar në kohë. Mbi bazën e tij u përpunua ky raport.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Sipas gjetjeve në SHLHPB, Dekani është drejtuesi kryesor i Fakultetit dhe emërohet me propozim të rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Marrëdhëniet ndërmjet personit juridik dhe dekanit përcaktohen në kontratën e punës. Dekani aktual i Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit është Dr.Ahmet Ecirli mban titullin 'Dr' (PhD e huaj, sipas kërkesës së ligjit për Arsimin e Lartë).

Neni 21, pika 3 b e ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin Nr.9832, datë 12.11.2007 qartazi tregon se "dekani/drejtori zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e fakultetit/institutit të kërkimit dhe zhvillimit/kolegjit profesional".

Përgjegjësi i departamentit të Shkencave të Edukimit është aktualisht Z. xxxx. Sipas ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin Nr.9832, datë 12.11.2007, neni 21, pika 3 c, "përgjegjësi i departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik respektiv" në SHLHPB, sipas pikës 9 të kompetencave të dekanit, ai "i sugjeron Rektorit përgjegjësit e departamenteve ndërmjet stafit akademik të departamentit, të cilët miratohen nga Këshilli i Lartë". Praktikat e zgjedhjes dhe emërimit të funksionarëve në detyrë të dekanit dhe të përgjegjësit të departamentit të Shkencave të Edukimit vlen të sillen në linjë me ligjin e arsimit të lartë. E drejta e zgjedhjes aktualisht duket të suprimohet nga të drejtat e Këshillit të Lartë të SHLHPB.

Në vitin akademik 2012-2013 pranë SHLHPB janë regjistruar gjithsej 488 studentë dhe janë angazhuar 97 pedagogë. Raporti studentë-pedagogë është 5.03. Për vitin akademik 2012-2013, në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit, raporti studentë/pedagogë është 251 studentë/44 pedagogë, pra 5.72.

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për

Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Tregues të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit
- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 1- 2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të pasqyruara në RVB)

Tabelat 1- 2

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit: Departamenti i Shkencave të Edukimit							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Ahmet Eklenci	Përgjegjës departamenti	Dr.	1	Tidita Abdurrahmani (kontrate e parinovuar)	Dr.	IZHA
2	Ana Uka	Koordinatori programi	MSc. (doktorante)	2	Arban Uka	Dr.	Universiteti "Epoka"
3	Matilda Likaj	Koordinatori programi	MA. (doktorante)	3	Yakup Çetin	Dr.	SHLHPB
4	Cihan Okuyucu	Lektor	Prof. Dr.	4	Ambera Duka	MA (Doktorante)	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
5	Mustafa Erdem	Lektor	MA.				
6	Murat Balkis	Lektor	Dr.				
7	Abdurrahman Celebi	Lektor	MA.(doktorant)				

Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit	Departamenti i Shkencave të Edukimit					
	Numri i PAE		Numri i PAK		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
Profesor Doktor	1	Prof	0		1	Prof. Dr.
Prof i Asociuar Doktor	0		0		0	Prof. Assoc.Dr.
Doktor	2	Dr.	3	Dr.	5	Dr
Doktorature në proces	3	MA/MSc	1	MA/MSc.	4	Dr në proces
Master	1		0		1	MA/MSc
Personel administrativ	0		0		0	
Total	7		4		11	

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 3)

Tabela 3

Titulli	Dep Shkencave të Edukimit
---------	---------------------------

	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	1	0	1/0
Profesorë të As.	0	0	0/0
Doktorë	2	3	2/3
Docentë	0	0	0/0
Pedagogë (pa tituj)	3	1	3/1
Asistentë me Ma	1	0	1/0
Asistentë pa Ma	0	0	0

Të dhënat sipas seksit

SHLHPB ka një balancë të drejtë gjinore në punësim si të pedagogëve efektive të brendshëm, ashtu edhe atyre të jashtëm.

Të dhëna sipas moshës së personelit

GKJ nuk mori të dhëna specifike për grupmoshat e personelit, po ata ishin kryesisht të rinj, nën moshën 45 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

GKJ u njoh me praktikat e punësimit dhe me kontratat e punës. Nuk u vërejtën praktika në kundërshtim me Kodin e Punës.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

GKJ u njoh me personelin e sekretarisë mësimore, sekretarisë së pranimit dhe bibliotekës. Ato kishin kualifikimet e nevojshme për punët që kryenin.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u panë dosje të personelit, të sekretarisë dhe dokumentacioni i anës mësimore. Nuk u vërejtjen shkelje të praktikave respektive.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardit/ kriterit
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>SHLHPB ndjek praktika të bëra publike për punësimin e personelit.</p> <p>Personeli me kohë të plotë sipas zyrës së burimeve njerëzore përbën 70% të personelit të angazhuar për zhvillimin e programit Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji. (Kontrata e Dr. Abdurramani u raportua si e parinovuar). Në semestrin e parë janë zhvilluar vetëm 5 lëndë, këto kryesisht nga stafi i brendshëm. Përlllogaritja është e pamundur të bëhet për realizimin e gjithë programit.</p> <p>Zyra e personelit dhe të dhënat e tyre tregojnë së SHLHPB ka numerikisht 70% të personelit të emëruar si të brendshëm.</p>

	<p>SHLHPB vlerëson periodikisht personelin e saj dhe e bën këtë përmes informacionit që mbledh nga studentët, raportet e grupit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë dhe analizës së aktivitetit shkencor të pedagogëve.</p> <p>Zyra e personelit në këtë shkollë të lartë kish bërë një punë metikuloze.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Zyra e personelit kish të dhëna të hollësishme të sistemuara me kujdes për anëtarët e personelit akademik dhe për përgjegjësin e departamentit dhe koordinatoren e programit të Psikologjisë së Këshillimit dhe Pedagogjisë.</p> <p>Aktualisht në Bachelor Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është zhvilluar vetëm një semestër. Departamenti dhe zyra e burimeve njerëzore kanë të dhëna për personelin e semestrit të parë dhe atij të dytë.</p> <p>Publikimi i procedurave të marrjes në punë nuk u vërtetua dot.</p> <p>’B angazhon personel akademik të brendshëm dhe të jashtëm me gradën Dr. në proces Dr. dhe Master.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Praktika e studentëve është planifikuar të bëhet në shkollat turke, po marrëveshjet mungojnë. Po ashtu mungon edhe personeli që do të angazhohet me të si edhe protokollet e zhvillimit të praktikës mësimore. Në raportin e vlerësimit të brendshëm behet fjalë për praktika të planifikuara për tu kryer brenda dhe jashtë vendit, kryesisht në Turqi dhe Gjermani, po gjatë vizitave në institucion nuk u vërtetuan dot këto marrëveshje.</p> <p>SHLHPB tregon seriozitet në rekrutimin, marrjen në punë dhe angazhimin e personelit mësimor.</p> <p>Praktika mësimore ende nuk është zhvilluar. Ky është semestri i dytë i programit me 6 semestra. Nuk mund të thuhet së si do të zhvillohet praktika, përveç që departamenti ka një plan të vendosjes së studentëve</p>

	<p>për praktikë në shkollat turke dhe medresetë. Kjo praktikë nuk arrin të plotësojë nevojat e synimeve të programit për të punësuar student të sistemit Bachelor edhe në organet e drejtësisë, në institucionet e shëndetit, shëndetit mendor, paaftësisë së fëmijëve dhe në agjenci të këshillimit dhe të psikoterapisë.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor; Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>SHLHPB buxhetin aktivitetin shkencor kualifikues të stafit të brendshëm. Çdo pedagog gëzon të drejtën e shpenzimit të 750E në vit për kërkimin shkencor. Për personelin është e qartë edhe skema e pikëzimit të mënyrës së shpenzimit dhe planifikimit të fondit për kërkim shkencor. SHLHPB disponon të dhëna të aktivitetit të saj shkencor në eeb-in e vet. Programi i Psikologjisë së Këshillimit dhe Pedagogjisë është relativisht i ri dhe departamenti ka të dhënat e dy semestrave të parë, por edhe të semestrave në vijim.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Programi është ende në fillim të zbatimit të tij. Departamenti i Shkencave të Edukimit është i angazhuar deri më tani për zhvillimin e tij. Do të duhen edhe pedagogë të tjerë të kualifikuar për zhvillimin deri në fund të tij. Duhet të hartëzohen dhe kontraktohen institucionet e praktikës, pasi vendosja e studentëve vetëm nëpër shkolla është i pamjaftueshëm për të arritur synimet për pajisjen e studentëve me shprehje për t'u punësuar në sektorë të ndryshëm të arsimit, shëndetësisë, drejtësisë, zhvillimit të fëmijëve, rehabilitimit dhe shëndetit mendor.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, rezidenat.

SHLHPB ka një marrëveshje me qeverinë shqiptar për të pronësuar (????) mjedise të ish shkollës së policisë në Sauk. Kancelari ndan informacionin së një fondacion(Fondacioni Sema) i ka rakorduar shkollës 10 milion Euro për restaurimin e godinave dhe vënien e tyre në eficencë për zhvillimin e programeve të studimit të kësaj shkollë të lartë. Deri më atëherë, SHLHPB ka marë me qera një mjedis të mjaftueshëm për zhvillimin e aktivitetit të saj. Sallat ishin mjaftueshëm, mjediset e studimit, mjediset rekreacionale dhe aksesore të mjediseve të përbashkëta ishin të mjaftueshme për kapacitetin aktual të studentëve në programin e Psikologjisë së Këshillimit dhe Pedagogjisë.

Tregues të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione (Po)
- Klasa për seminare (Po)
- Salla për aktivitete promovuese (Po)
- Salla për praktikë lëndore / profesionale (Jo)
- Laboratorë për lëndët (N/A)
- Laboratorë informatike (Po)
- Salla interneti (Po)
- Salla për bibliotekë (Po)
- Mjedis për fotokopjime, librari etj (Po)
- Zyrë informacioni për studentët (Po)
- Nyje hidrosanitare (Po)

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin (Po)
- Zyra për sekretarinë mësimore (Po)
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore (Po)
- Zyra për personelin akademik (Po)

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në SHLHPB, GVJ u njoh me modele kontratash të punës, modele të dosjeve të të punësuarve me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme, dokumentacionin e anës mësimore të departamentit, praktikat e aplikimit dhe rekrutimit, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardit/kriterit
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>SHLHPB ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë, relativisht të varfër në literaturë në fushë të psikologjisë dhe pedagogjisë. Studentët tregojnë se i kanë materialet mësimore në trajtë elektronike. Mënyra e përdorimit të tyre mbeti i paqartë për GVJ.</p> <p>Biblioteka aktualisht është e paorganizuar dhe me literaturë të pamjaftueshme për të rrokur nevojat e programit në psikologji këshillimi dhe pedagogji.</p> <p>Biblioteka nuk ka revista e periodike aktualë në fushë të psikologjisë dhe pedagogjisë.</p> <p>Departamenti, sipas kancelarit ka bërë porosi për blerje të fondit të librit.</p> <p>Mjediset e bibliotekës janë të hapura për studentët.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin</p>	<p>SHLHPB ka mjedise të mjaftueshme mësimore për numrin aktual të studentëve Bachelor.</p>

<p>e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjuterë në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Çdo auditor është i pajisur mjaftueshëm dhe cilësisht me mjete audio vizive për zhvillimin e mësimin.</p> <p>Laboratorët nuk janë specifikisht të përcaktuar në këtë program. Shkolla ka mjaftueshëm kompjutera dhe programe. Programi mësimor është ende në fillimet e zbatimit të tij, ndaj nuk mund të thuhet nëse ka pse mungojnë softet e duhura. Marrëveshjet e zhvillimit të praktikave mësimore janë vetëm në ide. Konsiderohen të lehta për t'u nënshkruar pasi janë në rrjetin e shkollave dhe medreseve turke. Por mbetet një sektor i gjerë i pambuluar me praktikë, siç janë shërbimet psikologjike në shkollat publike, shërbimet psikologjike në institucionet e shëndetësisë, në qendrat komunitare të shëndetit mendor, në institucionet e drejtësisë, etj.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Kriteri plotësohet pjesërisht, pasi program është në fillimet e veta dhe mjedisi aktual është me qera. Shkolla përgatitet për një mjedis me sipërfaqe më të madhe.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

SHLHPB menaxhoi një buxhet prej 65.000.000 Euro gjatë vitit të kaluar fiskal. Buxheti përbëhej prej të ardhurave të studenteve dhe të ardhurave nga Fondacioni Sema. Universiteti ka një politikë të qartë zhvillimi. Ai synon të prodhojë cilësi shumë më shumë se sa të krijojë shtrirje të gjerë në treg. Shkolla synon të tërheqë studentë ndërkombëtarë dhe të përgatisë staf për tregun ndërkombëtar. Për këtë vit dhe vitin që vjen financiar, shkolla synon të investojë në ndërtimin e kampusit universitar Bedër. Paralelisht shpenzimet dhe pagat janë në kujdes të plotë. Përpos, shkolla ka marrëveshje me institucione të tjera të cilat garantojnë shërbime më discount ose falas për stafin e shkollës Bedër. Kështu spitali amerikan ofron shërbimet e veta falas për stafin. Për punonjësit më kohë të plotë, shkolla paguan sigurimet. Nuk është e qartë nëse janë paguar sigurime komplementare për punonjësit më kontratë me kohë të pjesshme për semestrin e parë, pasi pagesat për të ende nuk ishin kryer. SHLHPB është e përjashtuar nga tatimet dhe taksat sipas një marrëveshjeje të komunitetit mysliman me qeverinë shqiptare. të ardhurat në buxhet nga studentet për vitin financiar 2012 ishin 14,811,159 ndërsa donacionet zin shifrën 50,589,655 ALL.

Beder ka një zyrë të kancelarit dhe një zyrë finance për të maanxhuar dhe planëzuar shpenzimet e veta.

Shpenzimet operative për vitin akademik 2011-2012 ishin 606,012 Euro, kështu që kostoja e përgjithshme për student ishte 606,012 Euro/187 studentë, pra 3240 Euro për student.

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi **(në përqindje):**

- Grandet për kërkim 0%
- Konsulencat, shërbimet 0%
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit: 14,811,159
- Sponsorizimet: 0 %
- Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm): 0%
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj: 50,589,655
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj):0%

Nga takimi me Kancelarin doli së buxheti i programit Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji formohet nga të ardhurat e studentëve dhe grandit i Fondacionit Sema. Këto dy prurje shkrihen në buxhet dhe administrohen si një e tërë. SHLHPB planifikon të ndërtojë kampusin e saj në Sauk me rreth 10 milion Euro. Këtë ajo e ka planifikuar për një periudhë 2 vjeçare. Pjesa tjetër e buxhetit është parashikuar për paga dhe shpenzime. Shpenzimet planifikohen nga departamentet dhe realizimi i tyre qendërzohet pranë kancelarit. Në buxhet parashikohen sipas kancelarit kërkimi shkencor, shërbimet për rrugë jashtë shtetit të stafit si dhe bursat e studentëve. Shkolla aplikon një tarifë studimi për studentët Bachelor, po jep edhe bursa për studentët me rezultate të larta apo me probleme sociale.

Kjo shkollë ka NIPT sekondar dhe auditi i behet fondacionit Sema. Të dhënat janë në total, nuk mund të kishim të dhëna për kostot dhe shpenzimet sipas departamenteve dhe programeve.

- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kostoja mesatare për një student (bruto) [për vitin fiskal 2012 ishte rreth 3500 Euro.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Për aspektin financiar u takua kancelari.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardit/kriterit
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe së ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Raportet financiare për këtë degë i perkasin vetëm periudhës shtator 2012-deri me sot. Nuk kanë qenë të detajuara.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	

<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj.;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Auditi nuk behet për SHLHPB pasi ajo ka NIPT sekondar. Auditi i behet Fondacionit Sema i cili mbulon edhe këtë shkollë. Raporti i auditit të fondacionit nuk ishte objekt i këqyrjes nga grupi i vlerësimit të jashtëm. Në raportin e vlerësimit të brendshëm pritej që në tremujorin e parë të këtij viti të bëhej edhe auditi i brendshëm dhe i jashtëm. SHLHPB realizon një buxhet prej rreth 65.000.000 Euro në vit.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë”, Bedër, ka të ardhurat e veta, po kryesisht mbahet më donacione të fondacionit Sema. Për sa kohë do të jetë kjo mbështetje duket së SHLHPB është e mbuluar në zërat e shpenzimeve të parashikuara për zhvillimin e saj.</p>	

